



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:017568

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05750755

Ac.nr.8299/21

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS ME SELI NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit dhe anëtarët e kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Arsim Hamzaj, në çështjen juridiko kontestimore të paditësit I.G. nga fshati Sh., Komuna e O., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z. K. avokat nga P. me autorizim , kundër të paditurës K. E. e K. Sh.A. (KEK) me seli në P. e përfaqësuar nga G. B. me autorizim, për shkak të kompensimit të dëmit nga lëndimi në punë, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga e paditura, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.587/2020 i datës 11.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë xx xx xxxx , nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET SI E BAZUARA ankesa e të paditurës K. E. e K. sh.a. (KEK) me seli në P., ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.587/2020 i datës 11.06.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në procedurën ri gjykuese, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.587/2020 i datës 11.06.2021, ka vendosur si në vijim:

I.APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.G. nga fshati Sh., Komuna e O.DETYROHET e paditura K. E. e K. Sh.A. (KEK) në P., që në emër të kompensimit të dëmit jo material të shkaktuar në aksidentin në vendin e punës të e paditura KEK-së më datë 13.01.2009 t’ia paguaj paditësit shumat si në vijim:

Në emër të dëmit jo-material:

Për dhimbje fizike-trupore, shumë prej.....2.000,00 euro

Për frikë shumë prej.....1.500,00 euro

Për zvogëlimin e aktivitetit jetësorë 15%.... ...1.600,00 euro

DETYROHET e paditura K. E. e K. Sh.A. (KEK) me seli në P., të paguaj shumat e gjykuara për paditësin si në pikën e I-rë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 5100 euro, të gjitha me kamatën ligjore si për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar në ndonjërin nga bankat e Kosovës, e cila do të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

II.REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë e paditësit për kompensimin e dëmit material dhe jo material përtej shumave të gjykuara si në pikën e I-rë të dispozitivit -si e pa bazuar.

III.DETYROHET e paditura K. E. e K.Sh.A. (KEK) me seli në P., që në afatin kohor prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shume prej 1796 euro, sipas suksesit në procedurë - të gjitha në afat në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Refuzohet pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e aprovuar -si e pa bazuar .

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka ushtruar e paditura për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës familjare me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Paditësi nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195, paragrafi, 1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurës K. E.E. e K.-KEK sh.a me seli në P., është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se I. G. nga fshati Sh., Komuna e O., përmes përfaqësuesit të autorizuar Z. K., avokat nga P., me datë 29.12.2009, ka ushtruar padi kundër të paditurës K.E. e K. Sh.A. (KEK) me seli në P. për kompensim dëmi me rastin e lëndimit në punë, në aksidentin që ka ndodh me datë 13.01.2009, i cili në padi, në shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se gjatë orarit të punës duke punuar në depon e të paditurës, duke zhvilluar aktivitetin e tij të përditshëm me urdhëresë të punës si anëtar i komisionit për regjistrim, për shkak të rrugës së pa pastruar në oborr e cila ishte akull dhe ngrica ka rrëshqitur me ç'rast ka marr lëndime të rënda trupore. Ky fakt është provuar më fletëparaqitje për fatkeqësi në punë nga e paditura e datës 14.01.2009, deklaratat e dëshmitareve okular punëtor të palës së paditur Sh. R. dhe Q. R., raporti i ekspertizës për mbrojtje dhe siguri në punë si dhe raportet e eksperteve ligjor ku është konstatuar gjendja e paditësit. Ka theksuar se nga të gjitha këto është vërtetuar fakti se në rastin e paditësit, e paditura nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore mbi mbrojtje dhe siguri në punë, se lëshimet e të paditurës konsistojnë në faktin se në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 2003/19

për siguri në pune dhe nenit 5, pika 5.11 të rregullorës për marrëdhënie pune të të paditurës ku parashihet që punonjësit me të meta nuk i lejohet të punoj me shume se 40 orë në javë , ndërsa në rastin konkret e paditura e detyron paditësin invalid të punoj natën në ndërrimin e tret, në kushte të vështira atmosferike ku ka ndodhur rasti. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar .

E paditura, në përgjigjen në padi, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë paditësit si të pabazuar. Nga provat ku më parë është refuzuar kërkesëpadia e paditësit është vërtetuar se janë eliminuar të metat ku vërtetohet se e paditura nuk mund të mbahet përgjegjëse për lëndimin e ndodhur e gjithashtu edhe nga plotësimet e ekspertit për mbrojtje në punë që ka deklaruar se vendi ku ka rreshqitur paditësi dhe është rrezuar është rrugë e destinuar për automjete dhe jo për kalimin e punëtorëve siç ka qenë rasti me paditësin. Në ekspertizë është cekur se trotualet janë të asfaltuara dhe nuk është përmendur ndonjë pengesë që i është paraqitur paditësit në drejtim të daljes nga vendi i punës , andaj në bazë të provave, parashtresave dhe deklarimeve janë dhënë argumente të mjaftueshme mbi bazën e provave materiale e që vërtetohet që e paditura duhet të lirohet nga përgjegjësia pasi që deri te lëndimi ka ardhur nga veprimet dhe moskujdesi i vet paditësit .Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas kthimit të lëndës në rigjykim, zhvillimit të procedurës kontestimore, nxjerrjes dhe administrimit të provave, nxjerr aktgjykimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në mes të palëve ndërgjygjëse nuk është kontestuese fakti se paditësi si punëtor tek e paditura ka pësuar lëndime gjate orarit të punës, ndërsa pala e paditur pretendon se në këtë rast nuk mban përgjegjësi për lëndimet e paditësit . Nga kontrata e punës nr. 41010/0 e datës 01.06.2008 vërtetohet se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të pacaktuar .Nga fletëparaqitja në fatkeqësi në punë e datës 14.01.2009 shihet se burim i fatkeqsisë në punë kan qenë kushtet e vështira akulli dhe bora ,ndërsa nga vendimi i të paditurës nr. 1775 të datës 27.12.2008 konstatohet se paditësi është caktuar antar i komisionit për regjistrimin e matrialit tek e paditura dhe pjesëve rezervë dhe inventarit.Nga kërkesa për punë me numër serik 000770 shihet se antarët e komisionit në mesin e të cilëve ishte edhe paditësi kan qenë të autorizuar që të bëjnë regjistrimin e matrialeve makinerike tek e paditura . Nga ekspertiza e ekspertit të mbrojtjes në punë nga Agim Millaku të datës 04.03.2013, vërtetohet se deri te lëndimi i paditësit ka ardhur si pasojë e rreshqitjes së paditësit pasi që rruga ka qenë me akull dhe e rrëqitshme. Ka theksuar se punëdhënësi i ka siguruar pajisjet mbrojtese personale si këpucët e punës, rrobat dhe helmeten por nuk ka mundur ta shmang rreshqitjen sepse rruga ka qenë e rrëqitshme dhe me akull.Andaj punëdhënësi me asnje veprim ose mosveprim të tij nuk ka ndikuar në lëndimin e punëtorit.Sipas procesverbalit të seancës së shqyrtimit kryesor të datës 11.05.2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë në rigjykim është ftuar eksperti i ekspertizës për mbrojtje në punë Agim Millaku. I njeti ka deklaruar se në ekspertizen time kam cekur se qendron fakti se punëmarrsit kane qenë të pajisur me pajisje të punës por që në këto kushte përsëri nuk kanë qenë të mjaftueshme që të sigurojnë lëvizje të sigurt të punëtorve për të vajtur në vendin e destinuar .Me tutje ka theksuar se në ekspertizën e paraqitur me shkrim nuk e kam potencuar faktin se mirëmbajtja e rrugës nga vendi i punës deri

tek dalja nga oborri i subjektit është përgjegjësi e punëdhenësit tani këtë fakt e shtoj në këtë seancë. Nga ekspertizat mjekësore e ekspertëve mjeksor Dr. Arber Tolaj ortoped dhe dr. Nazmije Musliu psikiatër, konstatohet se paditësi me rastin e rrëshqitjes ka pësuar lëndime të rënda trupore thyerje intraartikulare të kockës së radiusit distal të majtë, ka pësuar frikë primare dhe sekondare si dhe zvoglim të aktivitetit jetësor 15 %, shëmtim trupor nuk ka pasur .Dhimbjet fizike të intenzitetit posacërisht të rëndë kanë zgjatur për 30 minuta , të intenzitetit të rëndë kanë zgjatur 2 ditë, të intenzitetit të mesëm 21 dite.Frikë primare ka pasur disa sekonda, frikë sekondare të intenzitetit të lartë ka pasur 24 orë,frikë sekondare të intenzitetit të ultë 6 muaj.Në bazë të ekspertizave mjekësore dhe provave të gjithmbarshme të administruara lidhur me këtë çështje juridike, gjykata caktoi lartësinë e kompensimit jomaterial si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Lartësinë e kompensimit gjykata e caktoi duke marrë për bazë natyrën dhe shkallën e lëndimeve të paditësit sipas ekspertizave dhe meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e dëmit të krijuar ndaj paditësit, për kumatën ligjore, gjykata vendosi sipas dispozitës së nenit 277 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili ka qenë në fuqi dhe zbatim në kohën e lindjes së kontestit dhe parashtrimit të padisë. Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë e paditësit për kompensimin e dëmit material dhe kompensimin e dëmit jo material përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitivit -si e pa bazuar nga se gjykates nuk i janë ofruar prova per pjesen e refuzuar per damin matrial dhe per pjesen e damit jo matrial te refuzuar si ne dispozitiv.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe as shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese në ankesë, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe se e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) kjo për faktin Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare duke vërtetuar se paditësi me datën 13.01.2009 në aksidentin në vendin e punës është lënduar për shkak të rrugës së pa pastruar në oborrin e të paditurës e cila rrugë ishte me akull dhe me ngrica, ndërsa sipas ekspertizës mjekësore të hartuar nga Dr Arbër Tolaj ekspert i Ortopedisë dhe Dr Nazmije Musliu eksperte e psikiatrisë, lëndimet të cilat i ka pësuar paditësi klasifikohen si lëndime të rënda trupore.

Gjithashtu, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë nga

provat e administruara e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit është vërtetuar me provat materiale të bashkangjitur në lëndë, si fletëparaqitja në fatkeqësi në punë e datës 14.01.2009 nga e cila është konstatuar se deri të aksidenti ka ardhur si pasojë e kushteve të vështira atmosferike, konkretisht nga akulli dhe bora në oborrin e të paditurës që do të thotë se nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi me datë 13.01.2009, është lënduar gjatë orarit të rregullt të punës në oborrin e të paditurës, mirëpo kontestuese ka qenë përgjegjësia e të paditurës për lëndimin në punë që ka pësuar paditësi. Nga ekspertiza e ekspertit të mbrojtjes në punë, Agim Millaku e datës 04.03.2013, vërtetohet se deri të lëndimi i paditësit ka ardhur si pasojë e rrëshqitjes së paditësit pasi që rruga ka qenë me akull dhe e rrëshqitshme. Sipas ekspertizës së ekspertit Agim Millaku e po ashtu sipas procesverbalit të seancës së shqyrtimit kryesor të datës 11.05.2017 në të cilën seancë është ftuar eksperti për mbrojtje në punë Agim Millaku për të dhënë informata shtesë në raport me ekspertizën e tij, i njëjti ka theksuar se qëndron fakti se punëmarrësit kanë qenë të pajisur me pajisje të punës, por, këto kushte nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar lëvizjen e sigurt të punëtorëve për të vajtuar deri në destinimin e caktuar. Tutje, eksperti deklaron se mirëmbajtja e rrugës nga vendi i punës e deri tek dalja nga oborri është përgjegjësi e punëdhënësit, ndërsa nga përshkrimi i vendit ku ka ndodhur rrëshqitja e punëtorit shihet në mënyrë të qartë se lëndimi ka ndodhur në mesin e rrugës së destinuar për automjete dhe është evidente se punëdhënësi nuk e ka bërë mirëmbajtjen e rrugës edhe aty ku ka qenë e destinuar për komunikacion të automjeteve, ndërsa trotuari ka qenë shumë më i vështirë për të ecur se sa mesi i rrugës, andaj, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke iu referuar ekspertizës të ekspertit të mbrojtjes në punë, Agim Millaku e datës 04.03.2013, dhe sqarimeve shtesë të tij, drejtë ka vlerësuar se e paditura mbanë përgjegjësin për lëndimin e paditësit dhe konform përgjegjësisë së saj duhet të kompensoj paditësin ashtu siç është vendosur në e I-rë të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar sepse e paditura ka qenë e obliguar që të krijoj kushte për siguri gjatë lëvizjes së punëtorëve në oborrin e të paditurës, e paditura nuk ka bërë vlerësimin e hollësishëm mbi rrezikun e mundshëm gjatë ndikimit të reshurave atmosferike dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për të mos ardhur deri të rrëshqitja e punëtorëve. Si rrjedhojë refuzohen si të pa bazuara pretendimet e të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses pa asnjë sqarim nga ekspertiza e mbrojtjes në punë. Në këtë kontekst qëndron fakti se e paditura ia ka siguruar pajisjet personale për mbrojtje në punë paditësit, mirëpo, nga sqarimi i ekspertit të mbrojtjes në punë konstatohet fakti se e paditura nuk i ka ndërmarr masat e nevojshme për evitimin e rrezikut të mundshëm për të mos ardhur deri të rrëshqitja.

Gjithashtu, për Gjykatën e Apelit, edhe caktimi i lartësisë së kompensimit në emër të dëmit jo material i gjykuar si në pikën e I-rë të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar është i pranueshëm dhe në proporcion me natyrën, intensitetin dhe kohëzgjatjen e lëndimeve ngase nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, dhe për shkak të këtyre lëndimeve të pësuar, konsiston se i njëjti ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë me kohëzgjatje prej 30 minuta, dhimbje fizike me intensitet të lartë ka pasur me kohëzgjatje prej dy ditësh, dhimbje fizike të intensiteti të mesëm në kohëzgjatje prej njëzetënjë ditësh, dhimbje fizike me intensitet të ultë ka edhe me tej varësisht nga ndërrimi i kushteve atmosferike, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë 15%, njashtu, sipas ekspertit të psikiatrisë është konstatuar se paditësi si pasojë e këtij aksidenti ka përjetuar frikë dhe atë: frikë

primare të intensitetit të lartë për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej njëzet e katër orë, frikë sekondare të intensitetit të ultë ka përjetuar për gjashtë muaj, andaj të gjitha këto prova kanë vërtetuar faktin se paditësi i punësuar tek e paditura, me datën 13.01.2009, përderisa ishte duke punuar, kishte rëshqitur në vendin e tij të punës dhe si pasojë kishte marr lëndime të rënda trupore ku rezulton se deri te ky lëndim i paditësit ka ndodhë në mungesë të marrjes së masave parandaluese nga e paditura si punëdhënës i paditësit të përcaktuara me nenin 2, paragrafi 2.2 Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës Nr.2003/19 (ligj i aplikueshëm në kohën kur ka ndodh aksidenti) i cili parasheh “ *Punëdhënësi është i obliguar të organizojë dhe të ndërmerr masa të nevojshme për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë , ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtjen, makinerinë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendim e punës, mundësitë për të shkuar në vendin e punës*”, ngase e paditura nuk është përkujdesë për sigurinë në punë dhe vlerësimin e rrezikut, dhe mbi bazën e kësaj ka konstatuar se e njëjta është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditësit në vendin e punës, referuar dispozitë ligjore të nenit 154 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (vitit 1978 i aplikueshëm në kohën kur ka ndodh aksidenti) i cili parasheh se “ *Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*” dhe nenit 155 i cili parasheh se “ *Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*”

Në anën tjetër, Gjyjkata e Apelit e vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka vendosur drejtë me rastin e refuzimit të kërkespadiisë së paditësit si në pikën e II-të të dispozitivit për kompensimin e dëmit përtej shumave të gjykuara në pikën e I-rë të aktgjykimit të atakuar, pasi që shumat e gjykuara në pikën e I-rë të aktgjykimit për këto kategori të dëmit jo material janë në harmoni me lëndimet e paditësit dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit, ku sipas nenit 200, paragrafi 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (viti 1978) përcaktohet se: “*Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*”. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin në punë , e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit.

Gjithashtu, edhe kamata e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë është e drejtë dhe në përputhje me nenin 277 të LMD-së (viti 1978) si dhe Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/2020, datës 01.12.2020, përkatësisht pikën I, IV dhe XV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm, periudha e rrjedhjes së kamatëvonesës për dëmin material dhe jo material, ashtu që, në përputhje me këtë, gjykata e shkallës së parë ka

gjykuar si shkallën ashtu edhe momentin e rrjedhjes së saj, andaj, edhe pretendimet ankimore rezultojnë të pa bazuara.

Edhe sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata e shkallës së parë në përputhje të plotë me gjendjen faktike dhe rezultatin e vendosjes në këtë çështje juridike, në mbështetje të nenit 449 dhe 452 par.2 të LPK-së, përderisa paditësi ka pas sukses të pjesërishëm në këtë çështje juridike, ka gjykuar shumën e shpenzimeve si në pikën III të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar, të cilën shumë e mbështet edhe gjykata e shkallës së dytë, ngase janë shpenzime të krijuara dhe kanë qenë të domosdoshme në vërtetimin e bazës dhe lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit, andaj edhe duhet të paguhet nga e paditura.

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8299/21, me datë 20.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka